

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-219/11

**Prishtinë,
30 tetor 2012**

Në çështjen juridike të:

I.H.

Pala ankuese

vs.

V.L.

Parashtruesi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00339), i datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 30 tetor 2012, lëshoi këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011, i datës 23 shkurt 2011, vetëm për sa i përket pjesës së tij që ka të bëjë me kërkesën e regjistruar nën KPA00339 dhe ngastrën Nr. 1283/1, për shkak të mungesës së juridiksionit.
- 2- Hedhet poshtë kërkesa e paraqitur më 9 shkurt 2007 nga V.L., e regjistruar nën KPA00339, për sa i takon ngastrës nr. 1283/1, për shkak se bie jashtë juridiksionit të KKPK-ës.
- 3- Pala përgjegjëse në ankesë V.L. duhet të paguaj shpenzimet e procedurës të cilat janë në shumën prej € 55 (pesëdhjetë e pesë eurosh) brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditore nga data e dorëzimit të aktgjykimit ose përndryshe përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 9 shkurt 2007, V.L. kishte paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (KPA), ku kërkonte ri-posedimin e disa ngastrave, në mesin e tyre një pronë që ndodhej në komunën e Skenderajt, Zona Kadastrale Runik, ngastra Nr. 1283/1 në vendin e quajtur “Donje Livadhet” me një sipërfaqe prej 14 ari, 68 m², e regjistruar në Fletën Poseduese Nr. 77. Kërkesa ishte regjistruar si kërkesa KPA00339.

Me vendimin e tij të datës 23 shkurt 2011 (KPCC/D/A/100/2011) Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) vendosi në mes tjerash se parashtruesi i kërkesës kishte provuar se ai ishte pronar në 1/3 i ngastrave Nr. 837/1 dhe 1283/1 dhe se ai kishte të drejtë posedimi mbi pronat e lartpërmendura.

Me 5 dhjetor 2011, I.H. (pala ankuese) ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme ku theksonte se ai nuk kishte qenë i njoftuar për procedurën para KKPK-së dhe ku pretendonte se ai kishte blerë ngastrën kontestuese në vitin 1993 nga V.L.. Ai i kishte siguruar Gjykatës Supreme në mes tjerash një

kontratë të shitjes të pavërtetuar, që konstaton se V.L. i kishte shitur pronën e kontestuar I.H. në vitin 1993 për shumën prej 15.000 DEM. Ai gjithashtu kishte dorëzuar një kontratë të vërtetuar të datës 9 dhjetor 2008 me të cilën palët prapë kanë bërë bartjen e ngastrës, këtë herë për € 7.300. Kontrata ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale e Skenderajt – Nr. 1214/08 –.

V.L. (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) fillimisht nuk i është përgjigjur ankesës. Në shtator 2012, pasi që Gjykata kishte lëshuar një urdhër duke i dhënë atij mundësinë për tu përgjigjur, ai kishte dërguar një deklaratë të shkruar me dorë, ku deklaronte se në të vërtetë ai e kishte shitur ngastrën me kontratën e vitit 2008. Pala përgjegjëse në ankesë gjithashtu kishte dorëzuar një kopje të kontratës dhe kishte kërkuar nga AKP-ja të mbyllë këtë rast.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është pranueshme. Pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurë para KKKP-së, sidoqoftë ai është i arsyetuar pasi që ai nuk ishte njoftuar në mënyrën e duhur për këtë procedurë. Sipas jurisprudencës së gjykatës, njoftimi vetëm përmes publikimit të kërkesës – siç është kryer këtu – konsiderohet si “përpjekje e arsyeshme” e domosdoshme (Neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Lënda në fjalë nuk paraqet rrethana të tilla të jashtëzakonshme.

Në mënyrë që të përmbushen kërkesat për një kërkesë valide, parashtruesi i kërkesës apo bartësi i të drejtës pronësore duhet të dëshmojë se ai apo ajo ka pasur të drejtë pronësie apo të shfrytëzimit mbi pronën e kërkuar dhe se ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtën e tij apo të saj pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërdrejt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 (shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pasi që pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar se ai ia kishte shitur ngastrën palës ankuese, humbja e pronës nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.

Pasi që KKKP-ja nuk ishte njoftuar për këtë fakt, prandaj edhe nuk ka mundur ta marrë atë në konsideratë, vendimi i tij bazohet mbi vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike (Neni 12.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Rrjedhimisht Gjykata

Supreme konstaton se ankesa është e bazuar dhe se vendimi i KKKP-së duhet të anulohet.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (10.15 dhe 10.1 e UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë arsyeshmërisht mund të vlerësohet në shumën prej € 7.300 : 25 € (gjysma e pjesës së taksës sipas 10.1, por jo më shumë se 30 €).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 45 paragrafi 1 i Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave është 15 ditë. Paragrafi 3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it